



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 17.3.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha.

Mungoi : Velimir Rakiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 10.3.2015,
3. Shqyrtimi i draftit final të Komisionit për hartimin e Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.3.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i draftit final të Komisionit për hartimin e Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe pasi që pyeti për ndonjë vërejtje për këtë draft, anëtarë të pranishëm theksuan se ato i kanë bërë gjatë shqyrtimit në GP dhe mbledhjet e kaluara, ndaj Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Drafti i hartuar nga Komisioni i dërgohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës përmes së cilës do të procedohet më tutje në Qeverinë e Kosovës për dhënien e mendimit, që parashihet në Rregulloren e Kuvendit.

Shaip Muja u bashkëngjiti më vonë dhe kërkoi intervenime në draft sidomos rreth disa çështjeve si p.sh. blerjen e orëve, mirëpo **kryetari** tha se komisioni do të ketë mundësi prapë të involvohet në shqyrtimin e projektligjit pas leximit të parë, sepse ky draft, meqë hartohet nga komisioni, duhet të kalojë fillimisht përmes mendimit nga Qeveria.

4..Të ndryshme

Shaip Muja inicoi çështjen së ndotjes së ajrit në komunat e rrezikuara Drenas, Obiliq, Kaçanik dhe Trepçë, dhe të ftohet ministri i MMPH, pasi që ka dyshime dhe fakte që nuk monitorohen këto zona, ai gjithashtu kërkoi të shpërndahet imejlli i dërguar stafit ku anëtarët kanë mundësinë të njoftohen më detalisht, pasi që MMPH është paditur në Gjykatë lidhur me këtë problematikë.

Adem Salihaj nuk kundërshtoi këtë iniciativë por tha se komisioni ka për detyrë të kryej punën me çështjen e grurit, pastaj të kalojë në këtë problematikë, në çka u bashkëngjiti edhe **Salih Salihu** duke potencuar faktin se avancimin me çështjen e grurit komisioni nuk duhet ta ndërprej por ta finalizoi. **Shaip Muja** tha se nuk ka gjale nëse komisioni hap disa fronte, ngase personi që ka paditur MMPH ka kërkuar ngritjen e çështjes edhe në nivel të parlamentit, ndërkaq për çështjen e grurit potencoi se nuk bon të përfundoi pa ministrin përkatës. **Kryetari** gjithashtu u pajtua por komisioni të shkojë simbas rendit. **Lahi Brahimaj** shprehu dyshimin që në ndotjen e ajrit mos janë të involvuar edhe disa fabrika private duke potencuar se mund të ketë hakmarrje (i ceku ca shembuj), për çka edhe **Shaip Muja** nuk kundërshtoi dhe tha se ka pasur edhe ngordhje delesh etj por nuk dihet nga ajri apo nga ushqimi “prandaj po insistohet se nuk ka pasur kufar monitorimi”, përfundoi.

Komisioni u pajtua të shpërndahet imejlli i z. Muja dhe të caktohet për mbledhje të komisionit kjo problematikë, por pasi të kryhet intervistimi i kandidatëve për Komisionin e ZRRUK dhe pas shqyrtimit të çështjes së miellit dhe hartimit të rekomandimeve për seancën plenare. Komisioni gjithashtu pas diskutimeve për nismën e Ligjit për kompleksin Adem Jashari nxori :

P Ë R F U N D I M

1. MIRATOHET nisma për hartimin e ligjit për kompleksin Adem Jashari si ndryshim plotësim ose si ligj i ri, ashtu si do të vlerësohet në grupin punues i cili u formua në mbledhjen e fundit të këtij komisionit.

2. Të mbahet intervistimi i kandidatëve për Komisionin shqyrtues në ZRRUK më 19.3.2015 prej orës 9,30.

3. Grupi punues viziton kompaninë M&Silloi në Xërxë më 18.3.2015.

Në vazhdim komisioni vazhdoi konsultimet rreth përfundimit të çështjes së miellit duke analizuar **Salih Salihu** vizitën në IKB dhe duke konstatuar se aty në institut kishte një rregull, megjithatë përkundër konstatimit se nuk janë analizuar të gjitha mostrat, ai propozoi të përgatitet një raport sa më i sakt nga anëtarët e GP për Kuvendin. **Adem Salihaj** gjithashtu konstatoi se vizita në IKB ishte mjaft e frytshme, rezultatet e së cilës do të përfshihen në raportin përfundimtar por jo të përputhura me dy vizitat tjera që janë bërë në AUV dhe Dogana, prandaj propozoi që të kryhet edhe një vizitë në M SILLOS në mënyrë që të kompletohet hallka e shqyrtimeve të komisionit. Ai gjithashtu potencoi se analizat janë gjendur në IKB por jo edhe mostra, prandaj dyshimet nuk përfundojnë. **Shaip Muja** përsëriti qëndrimin nga mbledhjet e kaluara që duhet hulumtuar cilësinë e grurit që përdoret në Kosovë, ndërsa ikjet tjera si nga TVSH etj nuk është punë e këtij komisioni, ngase skandali me miell ka ndodhë pikrisht për

shkak të cilësisë së dobët, ai kërkoi edhe një herë përkthimin e dokumentit anglisht që ka pasur këtu në komision dhe konstatoi se AUV ka standarde por analizat nuk i ka të akredituar, duke përfunduar se komisioni nuk ka nevojë të hap front lufte por të përkrah ligjin për cilësinë e ushqimit. **Salih Salihu** shtoi se AUV nuk bënë analiza të kontaminimit dhe në përgjithësi është e pafuqishme, ajo me raportin e saj është jashtë funksionimit, ajo ka vetëm letra në bazë të cilave punon dhe asgjë tjetër, prandaj kjo duhet të potencohet në raport, të gjithë ushqehemi me ushqim të njejt, jo cilësore. **Lahi Brahimaj** përkrahu vizitën në M SILLOS dhe potencoi brengosjet nga mbledhja e kaluar se në Kosovë çdo ushqim është i dyshimt dhe pa kontrollë, mishi pulës (prej së cilës edhe kanë vdek njerëz), mishi i derrit (i cili përkundër faktit që nuk përdoret shumë nga popullata, qarkullon me tonelata në Kosovë dhe nuk dihet kah shkon), ushqimi kancerogjen (alfakeksi i cili është prap në treg edhe pse nga Evropa është identifikuar si kancerogjen), plehrat, farërat etj etj. **Murat Hoxha** mbështeti Shaip Mujën duke potencuar se me rëndësi është produkti final të jetë i mirë, ngase komisioni ku jemi investigon a kemi produkte të mira finale, nëse jo atëherë shkohet te xheneza kah ka ardhë ajo, a ka ikur tatimit apo jo, tjetër kush kujdeset, jo ky komision, pra duhet të shikohet produkti final. **Shaip Muja** polemizoi me disa mendime nga Lahi Brahimaj, ngase siç tha ai, dikush menjëherë pasi ta han një pulë mund të vdesë, mirëpo sinjali i rrezikshmërisë shfaqet nëse pas ngrënjes së pulave vdesin përnjëherë 4 apo 5 veta, për këtë arsye duhet ndjekur cilësinë e ushqimit. **Kryetari** potencoi faktin se gjatë vizitës në AUV vetë kryeshefi ka shfaqur mosbesim në stafin e tij duke premtuar komisionit se çdo dokument që ka hyr në doganë do të fotokopjohet dhe dorëzohet në komision, por që ky dokument ende nuk ka ardhur në komision. **Lahi Brahimaj** potencoi se nuk ka nevojë askush këtu të bëhet më i mençur, por ceku se i pari ka ngritur në këtë komision çështjen e grurit duke zmadhuar këtë çështje dhe që mos të përsëriten ngjarjet/rastet tragjike që kanë ndodhur me ushqimet tjera. **Shaip Muja** u pajtua që komisioni duhet të kërkojë nga AUV ngritjen e cilësisë jo vetëm të grurit por krejt ushqimit. **Salih Salihu** bëri përgjegjës AUV-in të cilin përfundimisht duhet ta qesim në binar, si tha ai për hir të sigurisë së ushqimit. **Murat Hoxha** pyeti grupin punues se a ka vërejt kapacitetet e AUV a janë të mjaftueshme për një funksionim të sigurt. **Adem Salihaj** u përgjigj se këto gjëra nuk kanë mundur menjëherë të vërtetohen me një takim të shkurtër, por pas analizave që do të bëhen edhe pas vizitës në M SILLOS me siguri do të përfundojë me sukses rekomandimi i komisionit, ngase si tha ai, cilësia nuk është i vetmi problem, p.sh. nëse thuhet : ky grurë nuk bënë për bluarje, ajo ashtu duhet të qëndroj dhe të tërhiqet e jo të përdoret për njerëz. **Emilija Redzepe** kërkoi nga komisioni të angazhohet rreth pyetjes për bashkëvendësit e sajë në Leposaviq pse nuk kanë mundur të konkurojnë në MB për subvencione dhe nuk kanë mundur ta marin vulën për aplikim, kjo pyetje ti parashtrahet ministrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 14,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Fikrim Damka